



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 3918 prot.

Tiranë, më 05.09.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1047, datë 31.07.2007.

SHOQËRISË “MEXHI” SH.P.K
Shtish Tufinë, pranë kafe “REI”, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT
NË MINIERA

Rr. “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Mexhi” sh.p.k ishte zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1047, datë 31.07.2007, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Brrar”, Tiranë.

Me shkresën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr.8114, datë 15.12.2017, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nr.3377, datë 18.12.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1047, datë 31.07.2007, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Brrar”, Tiranë, sepse ka mbaruar afati i vlefshmërisë së lejes prej 10 vitesh, afat i cili ka përfunduar më datë 31.07.2017.

Leja është dhënë me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, “Minerar të Shqipërisë”, të ndryshuar, që është shfuqizuar me Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në pikën nr.6, të nenit 24, të Ligjit të sipërcituar thuhet se: “Leja e shfrytëzimit e grupit të mineraleve ndërtimore ka afat vlefshmërie, jo më të gjatë se 25 vjet nga data e hyrjes së saj në fuqi dhe është subjekt i një shtese, deri në 10 vjet, me kusht që kjo shtyrje afati të kërkohej nga zotëruesi i lejes, të paktën, 180 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë. Afati i aplikimit është prekluziv dhe me kalimin e këtij afati, zotëruesi i lejes minerare humbet të drejtën e aplikimit për shtyrje të afatit të lejes së shfrytëzimit”.

Nga verifikimet në GIS, bazuar nëaktet ligjore për Zonat e Mbrojtura në Territorin e Shqipërisë, rezulton se, zona ku keni ushtruar aktivitet minerar ndodhet brenda Zonës së Mbrojtur, përcaktuar në VKM–në Nr.402, datë 21.06.2006, “Për shpalljen e Ekosistemit Natyror të Malit të Dajtit, Park Kombëtar ”.

Në zbatim të germave “a” dhe “b”, të pikës nr.2, të nenit 16 (Parku kombëtar, Kategoria II-të) të Ligjit nr.81/2017, datë 04.05.2017, “Për zonat e mbrojtura”, nuk lejohet zhvillimi i aktivitetit minerar brenda zonës së mbrojtur.

Kështu nga shoqëria “Mexhi” sh.p.k, nuk mund të aplikonte për zgjatje afati, sepse nuk plotësoheshin kushtet e lejimit, për të vijuar procedurat e shtyrjes së afatit të lejes minerare nr.1047, datë 31.07.2007, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Brrar”, Tiranë, për shkaqet që trajtuam më sipër.

Nga verifikimi që është bërë nga AKBN-ja, në objekt rezulton se shoqëria Juaj nuk ka bërë rehabilitimin e sipërfaqes së prekur nga zhvillimi i veprimtarisë minerare në objektin në fjalë, që është detyrim ligjor për një zotërues të një leje minerare, kështu nga ana e kësaj strukture përgjegjëse është propozuar revokimi i lejes minerare që ju zotëroni.

Me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.7650/1, datë 05.06.2018 “Mbi rehabilitimin e sipërfaqes së prekur nga shfrytëzimi, për lejen minerare nr.1047, datë 31.07.2007”, drejtuar shoqërisë Tuaj dhe për dijeni AKBN-së, është thënë se duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit të kësaj leje.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germën “e”, të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sipas nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1047, datë 31.07.2007**, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Brrar”, Tiranë, që shoqëria juaj zotëron.

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1047, datë 31.07.2007, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Brrar”, Tiranë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTA

